

Klasifikimi i strukturave akomoduese

***Ky shërbim është ekzistues në e-Albania**

Klasifikimi i strukturave akomoduese, është një proces vlerësimi që do të nënshtrohen të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari si strukturë akomoduese, në territorin e Shqipërisë. Kushtet, kriteret, afatet, tarifat dhe procedura përcaktohen në VKM nr. 730 datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, afatet, tarifat dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”.

Ky proces përfshin kategorizimin e strukturave akomoduese në:

- a) “Bujtinë” ;
- b) “Fjetinë” (Hostel);
- c) “Kamping”;
- ç) “Hotel”;
- d) “Motel”;
- e) “Resort”;
- f) “Qendër kurative”;
- g) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B)

dhe klasifikimin me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse:

- a) “Bujtinë” Standard;
- b) “Fjetinë” Standard, Komfort;
- c) “Kamping” Standard
- ç) “Hotel” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- d) “Motel” Standard, Komfort, Superior;
- e) “Resort” Tre yje, katër yje, pesë yje;
- f) “Qendër kurative” Dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje;
- g) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Procedura për marrjen e certifikatës

- a) Kërkesa për pajisjen me certifikatë klasifikimi

Sipërmarrësi turistik, që ushtron veprimtarinë strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi, duke plotësuar në sistemin elektronik e-Albania formularin e vetëdeklarimit.

- b) Procesi i verifikimit

1. Procesi i verifikimit të përmbushjes së kriterëve përkatëse nga struktura akomoduese kryhet nga Ministria përgjegjëse për turizmit, nëpërmjet Komisionit të Standardeve dhe bashkëpunon me agjenci dhe organizata ndërkombëtare të mirënjohura në fushën e vlerësimit të strukturave akomoduese.

2. Pas aplikimit kërkuesi njoftohet nga Ministria për kryerjen e pagesës së verifikimit për llogari të Ministrisë.

3. Pas kryerjes së pagesës së tarifës së verifikimit, kërkuesi njoftohet për datën e caktuar për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të strukturës akomoduese.

4. Pas përfundimit të verifikimit, formulari i plotësuar nga verifikuesit aksesohet në sistemin elektronik nga Komisioni dhe Kërkuesi nëpërmjet numrit të tij të aplikimit.

c) Vendimi Komisionit

Pas dorëzimit të formularit nga ana e verifikuesit, Komisioni, brenda 30 ditëve, shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin dhe të dhënat e paraqitura nga kërkuesi, rezultatet e verifikimit dhe përmbushjen e kriterëve.

Në përfundim të procesit, Komisioni vendos:

- Lëshimin e certifikatës së klasifikimit në të cilën përcaktohet kategoria dhe niveli i strukturës akomoduese

- Dhënien, vetëm një here, të një afati 60 ditor, për plotësimin e mangësive dhe kushteve minimale për lëshimin e certifikatës së klasifikimit. Në rast të mos përmbushjeve të kushteve sa më sipër, pas afatit 60 ditor, Komisioni vendos refuzimin e kërkesës për certifikatë klasifikimi.

d) Lëshimi i certifikatës së klasifikimit

Brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit për përcaktimin e kategorisë dhe nivelit të klasifikimit, Komisioni përgatit certifikatën e klasifikimit dhe njofton me shkrim kërkuesin për vendimin e marrë.